



DIALEKTE DHE STANDARDE

Isha 9 vjeç kur familja ime u transferua nga Tirana në Korçë. Në shtëpi flisnim një gjuhë të përafërt me shqipen standarde. Me fëmijët e lagjes deri në atë kohë duhet të kem folur diçka të përafërt me tiranasen.

Nga skenat e përballjeve të para me Korçën më ka mbetur në kujtesë dita kur u ngrita për herë të parë në dërrasë të zezë. Mësimin e dija shkëlqyeshëm dhe, sipas kërkesave të atëherëshme, po e riprodhoja rrjedhshëm. Megjithatë, e gjithë klasa s'pushonte së qeshuri. Unë u hutova dhe s'merrja vesh ç'bëhej. Më vonë, kur u ula, mësova se korçarët e vegjël ishin gudulisur nga mënyra se si i shqiptoja disa fjalë. Ishte një presion i përballueshëm.

Shumë shpejt m'u desh të filloja të flisja edhe unë si korçar. Për herë të parë bëhesha i ndërgegjshëm për dallimet midis dialekteve. Më vonë, kur shkoja për pushimet e verës te kushërinjtë në Shkodër, Tiranë dhe Fier fillova të shijoj larushinë e gjuhës shqipe. Unë dija më tepër fjalë se shumica e bashkëmoshatarëve të mij korçarë, sepse udhëtoja më shumë.

Dialektet dhe ndryshimet midis tyre më tërhiqnin dhe shumë herët isha në gjendje të dalloja nëse dikush vinte nga Korça apo nga zona e Devollit; nga Vithkuqi, apo nga Moglica, nga Dardha apo nga Vakëfet.

Arben Kallamata

Edhe më e lehtë ishte të dalloje nëse dikush ishte pogradecar, kolonjar, beratas, fierak, gjirokastrit, lushnjar apo vlonjat. Eshtë e mahnitshme, por në atë kohë (dhe në një farë mase ndoshta edhe tani) nuk ishte shumë e vështirë t'ia gjeje prejardhjen dikujt brenda një rrezeje prej jo më shumë se 5 ose 10 km vetëm duke e dëgjuar të fliste.

Ndryshimet dialektore janë pasojë e veçimit, e mungesës së shkëmbimeve midis grupeve të ndryshëm njerëzish. Popullsia të caktuara, kur veçohen nga njëra-tjetra, pa marrdhënie të mjaftueshme, pavarësisht se dikur mund të kenë pasur një gjuhë të përbashkët, të njësuar, fillojnë të zhvillojnë forma të ndryshme të përdorimit të të njëjtës gjuhë.

Gjuha është si një qenie e gjallë që zhvillohet në drejtime të ndryshme, sipas mjedisit ku jeton, sipas përdoruesve dhe rrethanave natyrore.

Kushdo që di anglisht e ka parasysh dallimin midis anglishtes britanike, asaj të ShBA-së, apo asaj të Australisë. E pra, afro 400 vjet më parë, në kohën e Shekspirit, ishin vetëm 3 milion njerëz që flisnin anglisht. Duke u shpërndarë dhe veçuar (të paktën deri në shekullin e kaluar) nga njeri-tjetri, ata zhvilluan dialekte fare mirë të dallueshme. Me kalimin e kohës, veçimi dhe zhvillimi i dialekteve pavarësisht nga njeri-tjetri mund të çojë në krijimin e gjuhëve pothuaj krejtësisht të ndryshme.

Jo më kot, ideja e klasifikimit të gjuhëve të botës nëpërmjet familjeve, si dhe e përcaktimit të disave prej tyre si degë të një trungu të përbashkët, pranohet sot përgjithësisht nga gjuhëtarët dhe historianët në të gjithë botën. Nga latinishtja e Romakëve kanë rrjedhur italishtja, spanjishtja, portugalishtja, rumanishtja, frëngjishtja etj. Rusishtja, bullgarishtja, polonishtja, çekishtja, sllovenishtja etj., kanë një burim të përbashkët sllav. Nga gjermanishtja ka ardhur anglishtja, danishtja, hollandishtja, suedishtja.

Shqipja ka dy dialekte kryesore: gegë dhe toskë. Ndarja midis tyre është gjeografike, një përrua i madh, ose lumë i vogël, merreni si të doni, që quhet Shkumbin. Por, hollë-hollë, ai nuk ndan por bashkon dy brigje!

Theksimi i të vërtetës së pranuar, shkencore, se dialektet janë pasojë e veçimit, është tepër i rëndësishëm kur flasim për dialektet e shqipes.

Ende qarkullojnë teori të çuditshme sipas të cilave dialektet e shqipes (dhe ky duhet të përbëjë një përjashtim vërtet të përsëritshëm) janë shprehje e pranisë së dy etnive krejtësisht të ndryshme. Nicholas Gage, për shembull, vërtitet nëpër qarqet akademike të ShBA-së duke trumbetuar se ndarja midis gegërishtes dhe toskërishtes është thjesht ndarje midis popullsisive me prejardhje epirote dhe ilire; se epirotët janë grekë, prandaj flasin toskërisht(!?).

Teori të tilla mbështesin pa-staj pretendimet greke mbi Epirin në përgjithësi dhe, në veçanti mbi Epirin e Veriut, ose Shqipërinë e Jugut.

Natyrisht, kjo teori është e pakuptimtë, si nga ana gjuhësore ashtu edhe nga ajo historike. Megjithatë, theksimi i dallimit midis gegërishtes dhe toskërishtes ka arritur të hyjë edhe në enciklopedi e udhëzues gjeografikë, ku vazhdimisht dy dialektet e Shqipërisë paraqiten si “të pakuptueshëm nga popullsitë përkatëse”. Gjë që çdo shqiptar e di mirë se nuk është e vërtetë.

Pavarësisht nga vështirësitë, një shqiptar nga Jugu e ka po aq të lehtë ose po aq të vështirë të kuptojë një shqiptar nga Veriu, sa e ka, për shembull, një qytetar nga Bostoni të kuptojë një tjetër nga Sidney.

Fatkeqësisht, në kurthin e përpjekjeve për të dramatizuar dallimet ndër-dialektore në shqip, bien jo rrallë edhe vetë shqiptarët. Dhe më së shumti mollë shërri bëhet gjuha standarde dhe origjina e saj.

Por, përpara se të vazhdoj me këtë sherr desha të sqaroj pak se si e shoh unë shqipen standarde dhe rolin që ka ajo në kuadrin e gjuhës shqipe në përgjithësi.

Siç e vura në dukje më lart, brenda dy ndarjeve të mëdha të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes, gëlojnë me dhjetra nëndialekte. Të gjithë bashkë, dialekte dhe nëndialekte, përbëjnë atë që konceptohet si Gjuha Shqipe. Nënveftësimi, injorimi apo mohimi i secilës pjesë s’bën gjë tjetër veçse dëmton dhe gjymton gjuhën, pasurinë e saj.

Sipas gjuhëtarëve, pasuria leksikore e një gjuhe vërtitet rreth 200.000 fjalëve (me përjashtim të anglishtes që numëron trefishin). Në vartësi të aftësive, prejardhjes, shkallës së arsimit, profesionit etj., njerëz të zakon-

shëm kanë në përdorim të përditshëm rreth 7-8000 fjalë. Brenda këtij inventari fjalësh, një mjek do të ketë më të përdorshme terma të mjekësisë; një kritik letrar do të ndjehet më mirë me figura dhe togfjalësha letrarë; një politikan do të flasë me zhargonin e politikës (që, me që ra fjala, është edhe pjesa më e ndotur e gjuhës), ndërsa një banor i fshatit do të përdorë më tepër fjalë që kanë lidhje me tokën, bagëtinë dhe veprimtarinë e tij të përditshme.

Gjithashtu, sipas krahinave prej nga vijnë, njerëz të ndryshëm do të përdorin më shumë fjalë apo shprehje gramatikore që përkojnë me ato anë - dialektin. Megjithatë, përdorimi që i bën secili nuk ka përse të dëmtojë të tjerën. Nga ana tjetër, asnjë njeri i veçantë nuk mund të jetë në gjendje të përdorë aktivisht të gjitha fjalët që përmban leksiku i gjuhës shqipe. Kjo është praktikisht e pamundur.

Duke qënë se njerëz të ndryshëm përdorin pjesëza të ndryshme të kësaj pasurie gjigande që quhet gjuhë, lind nevoja e krijimit të një marrëveshjeje sipas të cilës përdoruesit bien në një mendje që, në rrethana të caktuara, të përdorin njësi të përbashkëta. E këto njësi t’i përdorin sipas disa rregullave të përcaktuara.

Në fillim të shekullit XX-të shqiptarët u vunë të krijojnë shtetin. Pa kaluar shumë kohë, ata e panë se ky shtet kishte nevojë për një variant të njësuar të gjuhës së tyre. Për një Shqipe Standarde, ose Zyrtare – një dialekt që do ta njihnin, ta pranonin dhe ta përdornin të gjithë. Një gjuhë me të cilën shkresat që shkruheshin në komunat e Kukësit e të Sarandës të lexoheshin pa vështirësi në ministritë përkatëse, në Tiranë. Sepse, nuk mund të vije përballë një mjek,

që fliste me terma mjekësie, të diskutonte me një fshatar nga Progri i Devollit dhe të prisje që ai malësori i Nikaj Mërturit të hynte në bisedë pa u ngatërruar. Aq më tepër, t’ua regjistroje bisedën dhe të lije një jurist nga Vlora që të vendoste kush kishte të drejtë. Për këtë arsye lind nevoja e gjuhës zyrtare.

Ajo nuk u bë në kohën e Zogut; nuk u bë (dhe s’kishte s’i të bëhej) në “kohën e Italisë”; nuk u bë (dhe s’kishte si të bëhej) as në “kohën e gjermanit”. U bë në kohën e komunizmit.

Si çdo gjë që bëhej në komunizëm, do të mbante damkën e komunizmit. Damka që i dha komunizmi ishte animi i dukshëm nga dialektet jugore. Kjo damkë vazhdon ta ndjekë edhe sot. Por a është ajo e mjaftueshme që ta bëjë shqipen standarde ilegjitime dhe të justifikojë kërkesën për rishikimin e saj? Ose, a janë të justifikuar meritë dhe inatet që shpërthejnë herë pas herë midis shqiptarëve kur diskutojnë këtë temë?

Argumentet që përdoren edhe sot, për të mbajtur ndezur debatin për legjitimitetin e shqipes standarde, janë dy llojesh – politike dhe gjuhësore/kulturorë.

Parësor është pa dyshim argumenti politik. Sipas tij përcaktimi i toskërishtes si mbizotëruese u bë për t’i bërë qejfin Enver Hoxhës. Mua kjo më duket pak e vështirë për t’u kapërdirë. Jo sepse shumë shqiptarë, duke përfshirë edhe gjuhëtarët në atë kohë nuk përpiqeshin t’i bënin qejfin atij. Por thjesht sepse ai fliste dialekt gjirokastrit të theksuar, që ishte larg asaj që u miratua si gjuhë standarde. Të folurën e Hoxhës mund ta gjeje më lehtë te Ramiz Alia se sa tek shqipja standarde. Ndoshta, për një verior, të gjithë dialektet e Jugut tingëllojnë pothuajse një-lloj.

Por, nëse përshkojmë duke folur, një rrugëtim përgjatë gjithë vendit, nga veriu në jug dhe anasjelltas, fshat pas fshati, krahinë pas krahinë, bindemi se diferencat janë pothuaj të papërfillshme! Askund nuk gjen dot vijëndarje gjuhësore! Më duket se kjo na shërben si provë e qartë se shqipja është një gjuhë e vetme, e pasur, deri në atë shkallë sa pikërisht për shkak të kësaj larmie, shfaqet si një ylber gjigand. Praktikisht, e folura e Gjirokastrës ka po aq dallim nga e shqipja standarde sa ç'mund të ketë e folura e Kukësit nga ajo e Shkodrës. Nëse Kongresi i Drejtshkrimit do të kishte pasur si synim kryesor t'iu servirte gjithë shqiptarëve të folurën e Hoxhës, ne tani do të ishim të gjithë duke folur e shkruar gjirokastritçe.

Sidoqoftë duhet pranuar se animi nga toskërishtja ka pasur një farë shtytjeje politike. Ose të paktën ishte pasqyrim i mbi-zotërimit të pjesës jugore në jetën politike, akademike dhe kulturore të vendit, në një periudhë kur pjesa veriore (veçanërisht Shkodra) ishin goditur më rëndë nga komunizmi.

Pavarësisht prapaskenave që mund të kenë ndikuar në përcaktimin e standardit, shqiptarët u bënë me një gjuhë zyrtare. Zyrrat e shtetit filluan të komunikojnë me një gjuhë të një-suar. Fëmijët e shkollave në klasën e parë, filluan të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë gjuhë të një-suar. Mjetet e medias dhe të komunikimit filluan të përdorin një gjuhë të një-suar. Librat shkollorë dhe, më vonë, edhe ata artistikë, filluan të shkruhen me gjuhë të një-suar. Mua më duket se kjo nuk është e pakët, dhe pavarësisht nga motivet e përzgjedhjes, gjuha e një-suar ka luajtur një rol të shkëlqyer në njësimin e kombit.

Meqë jemi në planin politik, ia

vlen të përmenden dy reagime politike që janë tepër të rëndësishme, pavarësisht se diametralisht të kundërta. Nuk besoj të ketë pjesë tjetër të Shqipërisë ku njësimi i Gjuhës Standarde të jetë pritur me më tepër armiqësi se sa në Shkodër. Djep i një kulture tepër të lashtë, krenarë për një ndihmesë të pazëvendësueshme në letërsinë dhe kulturën e vendit, përdorues të një dialekti qytetar të përpunuar dhe të sofistikuar, qendër e antikomunizmit, Shkodra dhe shkodranët nuk kishin se si të mos e shihnin hapin e vënies së toskërishtes në bazë të gjuhës zyrtare si një sulm të drejtpërdrejtë kundër tyre. Aq më tepër që ky hap kryej krahas raprezaljeve të tjera ndaj kulturës dhe qytetëritimit shkodran – shkatërrimit të kishës, nëpërkëmbjes së dinjitetit, mohimit të figurave të shquara, rrënimit ekonomik, dënimit të intelektualëve. Reagimi i tyre ishte i hapur dhe i vendosur. Shkodranët, më shumë se gegët e tjerë, nuk e pranuan shqipen zyrtare. Ky reagim ishte thjesht politik dhe ishte shenjë qëndrese ndaj komunizmit. Edhe sot e kësaj dite, shkodranët e kanë më të vështirë se kushdo tjetër të flasin shqipen standarde. Kjo ndodh sepse, me ndërgegje apo jo, ata e konsiderojnë si një gjuhë jo të tyren, por jo për ndonjë arsye biologjike.

Gjithashtu politik, por me një drejtim të kundërt ishte reagimi i shqiptarëve të trevave të Kosovës. Ata panë tek shqipja e një-suar një rast të përsosur për të deklaruar identitetin e tyre. Prej kohësh shovinizmi serb bënte përpjekje për të përhapur idenë e dallimit midis shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Shqipërisë. Madje edhe emërtimet e përdorura për t'iu drejtuar atyre janë të ndryshme. Kjo bëhet me qëllim. Është i njëjti qëllim që i bën shovinistët grekë

të thonë se shqiptarët toskë janë të ndryshëm nga ata gegë. Dhe një nga argumentet që përdoret është dialekti i ndryshëm, duke pretenduar se dialekti flet për popullsi të ndryshme, dhe jo, siç është e vërteta historike dhe shkencore, që dialektet rrjedhin nga njerëz me origjinë të përbashkët të cilët, si rezultat i izolimit dhe jetesës në rrethana të ndryshme e kanë përdorur gjuhën në mënyra të ndryshme.

Shqiptarët e Kosovës e përqa-fuan Shqipen Standarde me një pasion të admirueshëm. Duke jetuar jashtë kufijve të vendit, për ta dallimet e brendshme politike në Shqipëri (komunistë - antikomunistë) nuk kishin më shumë rëndësi afatgjatë se sa dallimet etnike. Të kërcënuar nga asimilimi sllav, ata kërkonin mjete për të forcuar identitetin kombëtar shqiptar. Kjo shpjegon edhe popullaritetin që pati dhe vazhdon të ketë Shqipja Standarde edhe sot e kësaj dite në Kosovë.

Për shqiptarët e Kosovës, të flasësh shqipen standarde ishte gati shenjë patriotizmi dhe atdhedashurie. Pak rëndësi kishte nëse kjo gjuhë ishte bazuar te dialekti verior apo jugor. Madje pak rëndësi kishte që për ata vetë, dialekti i veriut do të ishte më i kapshëm dhe më i lehtë për t'u pranuar si standard.

Rëndësi kishte dhe ka që gjithë shqiptarët përdorin një gjuhë të përbashkët. Argumentët e tjerë që përdoren për të sulmuar shqipen standarde janë gjuhësorë dhe kulturorë. Sillen shembuj të pasurisë së fjalëve në veri, dhe kjo ia vlen e duhet përshëndetur, por bëhen përpjekje për të argumentuar se dialektet e jugut nuk e kanë një pasuri të tillë, gjë që më duket investim i pakuptueshëm. Nëse merr qëndrim përjashtues midis dy dialekteve, ky është nga ato lloj

(vijon në faqen 10)

FAKTORET E RREZIKUT PER KANCERIN E GJIRIT

Përkthyer dhe përshtatur nga Adela Kola,
M.D. Internal Medicine, Oak Park, IL, ShBA

(Ky material është për informacion të përgjithshëm dhe nuk zëvendëson këshillimin mjekësor. Kontaktoni mjekun tuaj me pyetje specifike rreth shëndetit dhe trajtimit mjekësor përkates).

Rreth 200.000 gra në ShBA diagnostikohen çdo vit me kancer gjiri. Jo të gjitha gratë kanë të njëjtën rrezikshmëri për të zhvilluar kancer gjiri. Studimet tregojnë se faktorë të caktuar, të quajtur faktorë rreziku, rrisin gjatë qe një grua të preket nga kanceri i gjirit. Shumica e këtyre faktorëve janë të përcaktuar por disa prej tyre janë të modifikueshëm.

FAKTORET E RREZIKUT

- Genet BRCA1/BRCA2
- Nëna/motra me kancer gjiri
- Moshë >35 vjeç, sidomos 70-74 vjeç
- Moshë e fillimit të ciklit menstrual <12 vjeç
- Moshë e shtatzanisë së parë >30 vjeç
- Moshë e menopauzës >55 vjeç
- Përdorimi i kontraktivëve
- Përdorimi i hormoneve në menopauzë
- Alkoholi 2-5 gota në ditë
- Dendësia e indit të gjoksit në mamogramë >75%
- Dendësia e indit kockor
- Biopsi gjoksi për probleme jokanceroze
- Biopsi gjoksi me çrregullime qelizore

FAKTORET MBROJTES

- Ushqimi i fëmijes me qumësht gjiri
- Numri i shtatzanive >5

- Ushtrimet fizike
- Indeksi i masës trupore pas menopauzes <22.9
- Mungesa (heqja) e vezoreve <35 vjeç

Meqenëse statistikat mund të jenë të paqarta për individin, çdo grua duhet të diskutojë me mjekun e saj për të përcaktuar rrezikshmërinë individuale të kancerit të gjirit.

Prania e faktorëve të rrezikut nuk do të thotë që kanceri është i paevitueshëm. Shumë gra me faktorë të lartë rreziku nuk preken nga kanceri i gjirit. Identifikimi i këtyre faktorëve ndihmon në përcaktimin e grave të cilat kanë nevojë për ndjekje të mëtejshme.

Gjithashtu është e rëndësishme të kuptohet se kanceri i gjirit prek edhe gra të cilat nuk kanë faktorë rreziku të njohur paraprakisht.

Një grua e cila nuk ka faktorë rreziku përveç moshës së sipërpërmendur ka një mundësi prej 10-15% prekjeje nga kanceri i gjirit nëse jetëgjatësia presupozohet 90-100 vjeç. Ndërkohë, rrezikshmëria e një kanceri fatal të patrajtueshëm është 3-5%.

Të gjitha gratë duhet të ndjekin këshillat e mjekut për mbikqyrjen e nevojshme lidhur me kancerin e gjirit pavarësisht nga numri i faktorëve të rrezikut që ato kanë. Disa nga këta faktorë të përmendur më sipër mbartin më shumë peshë se të tjerët.

FAKTORET ME TE RENDESISHEM

Për kancerin e gjirit nuk ka një faktor të vetëm i cili është më i rën-

dësishmi në zhvillimin e kancerit. Midis faktorëve të sipërpërmendur, tre prej tyre mbartin peshën kryesore:

1. Moshë: me kalimin e moshës rrezikshmëria për tu prekur nga kanceri i gjirit rritet. Në gratë e prekura nga kanceri i gjirit: 5% janë <30 vjeç
10% janë 40-49 vjeç
85% janë >50 vjeç

2. Historia familjare e kancerit të gjirit: gratë të cilat kanë së paku një pjesëtar të aftë të familjes (nëna, motra, vajza) me kancer gjiri përpara se ato të jenë në menopauzë, kanë gjasa më të mëdha për tu prekur nga kanceri i gjirit. Kjo ka të bëjë me dy gene të quajtur BRCA1 dhe BRCA2, të cilët mund të kenë çrregullime gjenetike të quajtur mutacione. Gratë që kanë mutacione në genin BRCA1 kanë rrezikshmërinë më të madhe. Rreth 1 ndër 1000 gra ka këtë mutacion.

3. Kancer i gjirit i mëparshëm: Gratë që kanë patur kancer në njerin gj, rrezikohen të preken nga kanceri në gjirin tjetër.

FAKTORET QE RRISIN RREZIKSHMERINE
Disa faktorë të tjerë pothuajse e dyfishojnë rrezikun e të prekurit nga kanceri i gjirit:

1. Çrregullimet në mamogramë: gratë që kanë kaluar në menopauzë të cilat kanë zona të dendura dhe nodularitete (nyje) në mamogramë.

2. Çrregullimet në biopsi: gratë biopsitë e të cilave tregojnë hiperplazi (rritje e tepërt/e shumëfishuar anormale).

3. Ekspozim ndaj rrezatimit me doza të larta të gjoksit: gratë të cilat janë trajtuar me rrezatim në zonën e gjoksit (zakonisht për trajtimin e ndonjë kanceri).

FAKTORET QE RRSIN DISI

RREZIKSHMERINE E KANCERIT TE GJIRIT

Lidhja e moshes me fazat dhe ngjarjet riprodhuese: gjatë viteve riprodhuese qelizat e gjoksit stimulohen nga estrogeni. Sa më i gjatë të jetë ky ekspozim ndaj estrogenit, aq më i lartë është rreziku i kancerit të gjirit. Nëse një femër fillon ciklin menstrual përpara moshës 12 vjeçare dhe kalon në menopauzë pas moshës 55 vjeçare, ekspozimi ndaj estrogenit është i lartë.

Shtatëzania dhe ushqimi me qumësht gjiri: gratë që s'kanë lindur fëmijë kanë rrezikshmëri më të lartë se ato me shumë fëmijë.

Mosha e nënës në shtatëzaninë e parë luan gjithashtu rol: gratë që kanë shtatëzaninë e parë të plotë mbi 30 vjeç kanë një rrezikshmëri më të lartë për tu prekur nga kanceri i gjirit.

Trajtimi me hormone: me kalimin e moshës, indi i gjoksit zëven-

dësohet nga indi dhjamor. Terapia me hormone përmban estrogenin i cili ngadalëson këtë proces. Një studim i gjerë klinik tregoi se përdorimi për një kohë të gjatë (rreth 5 vjet) i hormoneve të kombinuara estrogen-progjesteron në gratë e moshave 50-79 vjeç, rrit rrezikun e zhvillimit të kancerit të gjoksit, sëmundjeve të zemrës, ishemisë cerebrale dhe trombozave të venave të këmbëve.

Çdo grua duhet të diskutojë me mjekun e saj nëse kjo lloj terapie gjatë menopauzës është e përshatshme për të. Ekzistojnë trajtime të tjera alternativa të estrogenit.

Gjatësia dhe pesha: gratë shtatlarta kanë më shumë rrezik të preken nga kanceri i gjirit. Gratë mbipeshë gjithashtu kanë më shumë rrezik të preken sepse sasia e indit dhjamor në trup ndikon në metabolizmin e estrogenit.

Konsumimi i alkoolit: mund të ndikojë duke rritur nivelin e estro-

gjenit. Sa më i madh konsumi i alkoolit, aq më i madh rreziku për tu prekur nga kanceri i gjirit. Megjithatë doza të moderuara të pijeve kanë efekte mbrojtëse ndaj sëmundjeve të tjera. Gratë duhet të diskutojnë efektet dhe sasinë e konsumit të alkoolit me mjekun.

Prania e kancereve të tjera: grate e prekura nga kanceri i endometriumit, vezoreve dhe kolonit janë më të rrezikuara të preken nga kanceri i gjirit sesa gratë e tjera.

FAKTORE SHITESH

Shumë faktorë të tjerë mund të kenë lidhje me kancerin e gjirit, por mekanizmi i lidhjes së tyre është ende i paqartë. Disa nga këta faktorë janë: duhani, statusi ekonomik (gratë me status socio-ekonomik më të lartë kanë rrezik më të lartë), gratë që jetojnë në zonat urbane krahasimisht me ato në zonat rurale, etniciteti etj.

News • News • News

PC4, GJENI I RILINDJES MUSKULORE

Gjeni PC4 ka një rol kyç në riparimin e muskulit skeletor. Ky përfundim ka dalë nga studimi i koordinuar nga Felice Tirone i Institutit të Neurobiologjisë dhe Mjekësisë Molekulare të CNR (Inmm-Cnr) në Romë, Itali dhe i publikuar në revistën *Molecular and Cellular Biology*. Në rastin e një traume apo sëmundjeje degjenerative si distrofia muskulore, PC4 funksionon si një pengues biologjik duke aktivizuar faktorin e transkriptimit MyoD i cili me anë të një grupi gjenesh miogjenike nxit punën e "qelizave satelite". Këto qeliza staminale të muskulit shtohen e fillojnë të riparojnë fibrat muskulore të dëmtuara. Gjithë ky proces kryhet falë gjenit PC4 i cili duke hequr pengesën e rregullatorit negativ të MyoD, histon acetilaza 4 (HDAC4), favorizon zhvillimin e qelizave satelite e si rrjedhim edhe hipertrofinë e muskulit. Rezultatet e këtij studimi, tha Tirone, do të bëjnë të mundur shfrytëzimin e veprimtarisë së gjenit PC4 për të përmirësuar efikasitetin rigjenerues të qelizave satelite për ti përdorur gjatë trajtimit në terapinë e distrofive muskulore.

BAKTERET E PERGJUMUR

Një bakter i mbetur i përgjumur për 32 mijë vjet në një liqen të ngrirë në Alaskë, u soll në jetë nga shkencëtarët e Nasa-s. I quajtur *Carnobacterium Pleistocenium*, ai i takon kohës së pleistocenit, era kur mamuthët ishin ende të pranishëm në Tokë dhe e karakterizuar nga akullnajat e mëdha dhe shfaqja e hominidëve të parë. Zbulimi u krye nga një grup studimi i kryesuar nga astrobiologu amerikan Richard Hoover. Në veçanti, mikroorganizmat u gjetën pranë dhëmbit të fosilizuar të një mamuthi që kish tërhequr vëmendjen e studiuesve për ngjyrën e theksuar kafe. Pasi u shkri akulli, bakteret filluan të lëvizin në epruvetat e vrojtimit. Vrojtimi në mikroskop dhe studimet e kryera mbi vargëzimin e tyre gjenetik treguan se i përkisnin një specieje të re. Gjëja më e rëndësishme e këtij zbulimi, siç theksoi edhe Hoover, qendron në faktin e provuar se mikroorganizmat e pranishëm normalisht në temperaturë mjedisi, mund të konservohen në akull për periudha shumë të gjata kohe.

LIBER I RI PER EMIGRACIONIN SHQIPTAR

*Juli Vullnetari,
Ph.D., Universiteti i Sussexit, Angli*

Sapo ka dalë nga shtypi libri *The new Albanian migration* i shkruar nga Russell King, Mai, N. and Schwandner-Sievers, S.

Ky libër është një material bazë për studiuesit e emigrimit europian dhe për specialistët e studimeve shqiptare, ballkanike e mesdhetare.

Vëllimi hapet me një kapitull nga Russell King dhe Kosta Barjaba ku analizohet dhe teoretizohet emigracioni shqiptar, me fokusim në atë pas-1990, por duke e parë në këndvështrim historik, pra të lidhur me atë 1944-90 dhe para vitit 1944. Autorët përqendrohen në emigrimin e shqiptarëve nga Republika e Shqipërisë. Megjithatë, sidomos në vështrimin historik, përmenden edhe emigrime të shqiptarëve të trevave të tjera.

Kapitujt e librit trajtojnë kryesisht emigrimin e shqiptarëve në Europë, dhe sidomos në Greqi e Itali, ku dhe është përqendruar shumica e emigrantëve shqiptarë. Ndër argumentat kryesorë gjejmë: shkaqet, kronologjinë dhe teorizimin mbi këtë emigrim të shqiptarëve; reagimin problematik të shoqërisë greke ndaj pranisë së papritur të 500 mijë imigrantëve shqiptarë; perspektiva e një përdorimi strategjik të këtij emigracioni për të nxitur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë; dinamikat e emigrimit, etnicitetit dhe identitetit kombëtar në zonën e kufirit greko-shqiptar.

Kapitulli i shkruar nga Aida Orgocka (anëtare e kahershme e Alb-Shkencës) mbi emigracionin e grave shqiptare me arsim të lartë në ShBA, jep një kontri-


but për konsiderimin e një hapësire më të gjerë gjeografike.

Dy janë arsytet për këtë shtrirje gjeografike "të ngushtë":

1- Shumica e punimeve shkencore që trajtojnë emigrimin e shqiptarëve jashtë vendit kanë si fokus Europën dhe sidomos Greqinë dhe Italinë. E kuptueshme, duke qenë se dhe shumica e emigrantëve shqiptarë ndodhen në këto dy vende fqinjë.

2- Ky liber erdhi si rezultat i prezantimeve të bëra në konferencën e parë mbi emigracionin shqiptar, të organizuar nga Universiteti i Sussexit në Angli në shtator 2002, edhe pse punimet në libër janë modifikuar për të perfishirë edhe ndryshimet e këtyre dy viteve të fundit.

**THE NEW ALBANIAN
MIGRATION**
(King, R., Mai, N. Schwandner-
Sievers, S.)
Sussex Academic Press
ISBN 1 903900 78 6
252 faqe, çmimi £49.50/\$65

FJALORI SINONIMIK
I GJUHËS SHQIPE

Kohët e fundit doli në qarkullim një fjalor i plotë sinonimik i gjuhës shqipe. Ky fjalor për të cilin kanë punuar gjuhëtarët Jani Thomai, Miço Samara, Hajri Shehu e Thanas Feka, përmban 29 mijë fjalë dhe është i pajisur me disa ndarje kuptimore, shpjegime e shembuj ilustrues.

Sipas vetë autorëve, *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe* është përpjekja e parë për ta pasqyruar sistemin sinonimik të shqipes me lidhjet, veçoritë e përmbajtjes e të përdorimit. Gjithashtu ky fjalor rreket të vërë në dukje pasurinë e gjuhës shqipe e të eliminojë huazimet nga gjuhët e huaja.

Ky vëllim iu vlen jo vetëm gjuhëtarëve, studiuesve e shkrimtarëve, por edhe studentëve e të huajve që mësojnë shqipen, pra të gjithë atyre që synojnë një ligjërim të pasur e jo monoton.

Qëllimi i fjalorit ka qenë të sjellë të sistemuar dhe me vlerat e veta sa më shumë sinonime, të shumë shtresave leksikore, deri në nivelin e një fjalori të tipit të mesmë. Për realizimin e tij, autorët i janë referuar burimeve të ndryshme, si fjalorëve shpjegues të shqipes, kartotekave e leksikut të shqipes dhe fjalorëve të tjerë.

Fjalori Sinonimik i gjuhës shqipe është një botim i Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë.

Të nderuar lexues, herë pas here, në buletin tonë do të botojmë lajmërimi të ndryshme për bursa studimi, konferenca e simpoziume shkencore të cilat mund të jenë me interes për ju. Këto lajmërimi vijnë nga burime të ndryshme dhe kryesisht në anglisht. Nga pamundësia e bashkëpunëtorëve tanë për ti përkthyer, ne shpesh do ti botojmë në gjuhën origjinale të shoqëruara me pak fjale në shqip

**SCHOLARSHIP PROGRAMS
GLOBAL SUPPLEMENTARY
GRANT PROGRAM**

The Global Supplementary Grant Program offers supplementary grants to students from selected countries of Central and Eastern Europe and the former Soviet Union. The grants enable qualified students to pursue doctoral studies in the humanities and social sciences at accredited universities in Western Europe, the Middle/ Near East, Asia, Australia, and North America. Grants are awarded on the basis of academic record, merit of the proposed study, applicant's long-term goals, and financial need. Supplemental funding is provided for one year of study with the option to apply for a second year. Reapplication procedures are outlined in the 2005-2006 application form. Renewal grants are not guaranteed; competition for renewal takes place among the general pool of applicants. Only students who have been accepted into a full-time doctoral (Ph.D.) program at an accredited university are eligible to apply.

Grants are provided to help cover costs in one of the following categories:

- Tuition and fees: not to exceed 50 percent of tuition and fees per academic year;
- Living expenses: students who have succeeded in funding their tuition, either through scholarships or tuition waivers, are eligible for housing and living funds;
- Other: students who have secured all necessary funds but

cannot afford additional expenses, such as travel to/from their host country, books, materials, or health insurance are eligible for additional funds.

Grants will not be provided to cover expenses in all three categories. Only those students with confirmed financial support will receive grants. In addition, in no case may an applicant request grant assistance for the support of an accompanying child or spouse.

Eligibility

1. Candidates must be nationals of one of the following countries: Albania, Armenia, Azerbaijan, Belarus, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Georgia, Kazakhstan, Kyrgyzstan, Macedonia, Moldova, Mongolia, Romania, Russia, Serbia and Montenegro, Tajikistan, Turkmenistan, Ukraine, and Uzbekistan.

2. Members of the Roma community are encouraged to apply.

3. Candidates must be under 40 years of age at the time of application.

4. Candidates must demonstrate proficiency in the spoken and written language of their host institution.

5. Only those students who have already been awarded partial or full tuition, room and board stipends, or other types of financial aid may apply.

Applicants must provide the fullest possible account of their financial situation, including copies of financial aid requests to the host university and any other documents confirming additional financial support.

False statements will result in immediate disqualification.

Selection

Students are selected in an open competition announced once per year. A team of experts (the GSGP Board) makes all grant decisions based on quality of the application, written essays, academic records, and future goals. Preference will be given to students pursuing advanced studies in regionally relevant areas that will directly benefit the quality of academic and civil society development in their home country. Selection Committee decisions are final.

Applicants should send one copy of each of the following documents, including an official or university translation if language is other than English.

1. Curriculum vitae (including complete work history, extracurricular activities, academic awards, and publications);
2. A copy of the official letter of admission from the academic institution (if not available, explain why);
3. Copies of all undergraduate and post-secondary school records (new applicants only);
4. The official letter informing the applicant of the details of the scholarship or financial aid award (if separate from item 2 above) and/or any other documents confirming additional support;
5. A copy of the identification pages of applicant's passport;
6. Copy of applicant's visa (students in the United States should also enclose copy of their I-20 or DS-2019);

7. Two academic reference letters from professors who have direct knowledge of the applicant's work and abilities.

NOTE: Omission of one or more of the documents mentioned above renders an application incomplete and may result in disqualification. In the event that a document becomes available only after the submission of an application, applicants are asked to indicate this in their applications and to send the missing document as soon as possible.

APPLICATION AND DEADLINES

Applicants may apply for a grant using OSI's Online Application System. Alternatively, applicants may download an

application from this page and apply offline.

Applications for the 2005-2006 academic year must be postmarked (or submitted online) on or before the following:

For students pursuing a Ph.D. in North America, Asia, or Australia: April 1, 2005.

For students pursuing a Ph.D. in Western Europe or the Middle/Near East: June 3, 2005.

Applications should be mailed to the address below or to applicant's local Soros foundation office:

Global Supplementary Grant Program
Open Society Institute
400 West 59th Street, 4th floor,
New York, NY 10019 USA.

Contact information for additional questions about the

program:

E-mail: scholar@sorosny.org

Tel: 1-212-548-0175

Fax: 1-212-548-4652

Please include any information you feel may be helpful in the evaluation of your application. Grantees will be required to maintain full-time student status throughout the period of the fellowship and to abide by the terms and conditions outlined in a contract letter signed by the grantee.

http://www.soros.org/initiatives/scholarship/focus_areas/global_supplementary/guidelines

News • News • News

RECEPTORET E NUHATJES DHE SHQETESIMI BIPOLAR

Falë studimit të parë që mori në shqyrtim qelizat e gjalla nervore të pacientëve me probleme psikiatrike, kërkuesit e Monell Chemical Senses Center, në Universitetin e Pennsilvanisë vunë re funksionim jo të rregullt të receptorëve të neuroneve të nuhatjes tek pacientët që vuajnë nga bipolarizmi. Si shqetësime të tjera psikiatrike e neurodegenerative, bipolarizmi ndikon mbi neuronet e trurit duke e bërë të vështirë studimin e shkaqeve neurobiologjike të sëmundjes kur ajo është në vijim.

Sipas biologes Nancy Rawson, autore kryesore e studimit, "kërkimet e mëparshme kishin përdorur vetëm qeliza nervore si fibroblastet apo rruazat e kuqe, për të parë funksionimin e tyre tek pacientët që vuajnë nga ky shqetësim. Por meqë kemi të bëjmë me një problem psikiatrik, është e nevojshme që të dimë se ç'ndodh tek neuronet".

Neuronet e nuhatjes, që ndodhen në një zonë të vogël të epitelit në brendësi të hundës, janë qeliza që përmbajnë receptorë për mijëra molekula aromatike që dallohen prej qenieve njerëzore. Të përfutueshëm lehtësisht në pesë minuta me një procedure të thjeshtë biopsie, këta neurone kanë shumë karakteristika të përbashkëta ma ata të trurit gjë që i bën një model të vlefshëm për të studiuar efektet neuronale të sëmundjeve psikiatrike.

Për funksionimin e tyre korrekt është i nevojshëm kaliumi. Studimet e mëparshme kanë sugjeruar se mos funksionimi si duhet i metabolizmit qelizor të kaliumit ishte një nga faktorët që ndikojnë mbi problemin e shqetësimin bipolar. Ndryshimet e sasisë së kaliumit tek neuronet mund tju tregojë shkencëtarëve se si nervat i përgjigjen stimulimit.

rawson dhe kolegët përdorën teknikën e fluoreshencës për të matur nivelet e kaliumit bazë e të stimuluar në receptorët e nuhatjes së 17 pacientëve me shqetësimin bipolar. Rezultatet treguan se tek pacientët përgjigja ndaj kaliumit ishte tepër e reduktuar. "Ky zbulim - shpjegon shkencëtarja - do të na lejojë ti përqendrojmë kërkimet në identifikimin e difektit të shoqëruar me shqetësimin bipolar dhe të arrijmë të prodhojmë barna mjekësore të reja".

C.-G. Hahn, G. Gomez, D. Restrepo, E. Friedman, R. Josiassen, E. A. Pribitkin, L. D. Lowry, R. J. Gallop, N. E. Rawson, *Aberrant Intracellular Calcium Signaling in Olfactory Neurons From Patients With Bipolar Disorder*. American Journal of Psychiatry, 2005, 162 (3).

**INTERNATIONAL
CONFERENCE
"ORAL HISTORY IN
(POST) SOCIALIST SOCIETIES"
3-5 NOVEMBER 2005,
FREIBURG/BREISGAU,
GERMANY**

Oral History provides a valuable and unique contribution to the investigation of societies in the former socialist states before and after the collapse of communism. Although many researchers now work with biographical interviews (e.g. on Czechoslovakia, the German Democratic Republic, Hungary, the Soviet Union, Bulgaria and Yugoslavia), there has been only limited international exchange on the methods, aims and results of Oral History concerning the analysis of socialist societies in Europe until 1989-1991.

The conference offers a platform for the discussion of methods, content and research strategies and aims to consolidate (first) results. The following issues will be focussed:

- What can we learn from Oral History interviews about the functioning of socialist societies (with reference to social relations, networks, gender relations, family structures, alternative cultures, etc.)?

- What do interviews reveal about the non-functioning and final implosion of socialist societies?

- How are collective and individual identities constructed in narrative interviews (beyond the changes due to political transition)?

- Which forms of biographical communication and narrative tradition were characteristic in socialist societies?

- What role did national or regional narrative cultures play? Can they be distinguished from 'socialist' biographical patterns of communication?

- What role did ? and do ? oral narratives play in the memory culture of socialist and post-socialist societies? In how far has 'transition' altered collective memory?

- Which methods do we use in conducting, evaluating and interpreting interviews?

- What can we conclude from recent results in neurology, memory research, discourse analysis and other fields, in relation to Oral History interviews?

- How can Eastern European History contribute to the further development of methods relevant to Oral History?

The conference programme will consist of four to five sections, each with three to four speakers and one discussant. The conference languages will be German and English. Mutual translation will be provided. Since we would like to allow plenty of time for discussion, the presentations should not extend beyond 30 minutes. The conference will be held in the Haus Wiesneck conference centre in the beautiful surroundings of Freiburg/Breisgau, not far from the Himmelreich train station. The tranquil location will allow us to fully concentrate on our work, and also offers the possibility for outdoor relaxation. There will be enough time after the conference for a short trip to Freiburg.

Please send a paper proposal (maximum one page) no later than 25 March 2005. Presentations should clarify the theoretical basis of research as well as the methodological approach. Both should be included in the proposal.

The papers will be published in a conference volume.

Organisation:
Albert-Ludwigs-Universität Freiburg

Dr. Julia Obertreis
Historisches Seminar
Lehrstuhl für Neuere und Ost-europäische Geschichte
Tel.: +49-(0)761 / 203-3441
Fax: +49-(0)761 / 203-9190
julia.obertreis@geschichte.uni-freiburg.de

Ludwig-Maximilians-Universität München
Dr. des. Anke Stephan
Historisches Seminar
Abteilung für Geschichte Ost- und Südosteuropas
Tel.: +49-(0)89 / 2180-1486
Fax: +49-(0)89 / 2180-5656
anke.stephan@lrz.uni-muenchen.de

Please send your paper proposal to:
anke.stephan@lrz.uni-muenchen.de

(vijon nga faqja 3)

argumente që hapin debate pafund. Të gjithë dialektet janë të pasur dhe të aftë të shprehin vetveten. Mbrojtja e njërit në kurriz të tjetrit nuk mund të të çojë kërkund. Është e vërtetë që gegërishtja ka pasuri të rralla leksikore, po aq sa është e vërtetë që shqipja e jugut ka qënë në gjendje të shprehë shkëlqyeshëm vlera të mirëfillta letrare.

E keqja ka qëndruar dhe qëndron pikërisht te pozicioni përjashtues. Siç e shpreha edhe më lart, prania e një gjuhe standarde nuk ka përse të përjashtojë dialektet. Përkundrazi, ato janë pjesë dhe pasuri e gjuhës shqipe.

Përjashtimi çohet pastaj më tej, në planin kulturor. Përmen-den shkrimtarë dhe figura të shquara me prejardhje nga trevat e veriut dhe bëhen përpjekje për t'ua kundërvënë ata shkrimtarëve me prejardhje nga trevat e jugut. Kjo është vërtet e shëmtuar dhe e pafrytshme. Asnjë

shkodran nuk ka të drejtë ta pretendojë Fishtën ose Mjedën si poetin e vet dhe t'ia mohojë atë vlonjatëve apo korçarëve. Kada-reja nuk është shkrimtar gjirokastrit, ashtu si as Naimi nuk është poet frashërlli apo nga Stambolli, dhe as Fan Noli nuk i përket Ibrik Tepesë apo Bostonit. Të gjithë këta i përkasin Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që janë, nga Preveza në Preshevë, madje, në kushtet moderne, nga Pekini në Vancouver.

Si përfundim dua të përsëris se standardi i shqipes as duhet t'i përjashtojë dhe as t'i mohojë dialektet. Përkundrazi, ai duhet të jetë një mjet njësimi, mjet bashkimi për kombin. Pavarësisht rrethanave në të cilat u vendos, ai ka luajtur dhe luan një rol që në përgjithësi është provuar se është pozitiv. Të kërkosh ta zëvendësosh atë në këtë kohë është humbje e kotë energjish. Të vihemi në lëvizje për ta ndryshuar, përmirësuar, plotë-

suar, po. Por kjo nuk është mision vetëm i veriorëve.

Mungesat janë të gjuhës shqipe, jo të banorëve të njerës apo tjetrës trevë. Për më tepër, përpjekja si revansh, mund të kthehet në një aventurë të rrezikshme dhe me pasoja. Argumentët politikë për ta kundërshtuar atë - urrejtja për komunizmin dhe komunistët - pothuajse nuk ekzistojnë më, së paku zyrtarisht. Argumenti politik për ta ruajtur gjuhën e njësuar - në kuadër të njësimi të kombit, vazhdon të jetë jo më pak i mprehtë se më parë. Sa për argumentat gjuhësorë - shqipja do të vazhdojë të mbetet pasuri për aq kohë sa të gjithë dialektet, pavarësisht nga standardi, do të vazhdojnë t'i sjellin asaj vlera. Dhe këtu kam parasysh të gjitha dialektet, ato të Kosovës, të Shkodrës, të gjithë veriut, por edhe dialektet e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut.

Arben Kallamata

News • News • News

NJE FORCE SHTYTESE MISTERIOZE

(Mund të shfrytëzohet në fushën e kimisë dhe atë farmaceutike)

Qysh nga vitet shtatëdhjetë, shkencëtarët kanë kërkuar të gjejnë shkaqet e një force shtytëse që haset midis molekulave me ngarkesa të ndryshme elektrostatische si ADN-ja e biomolekula të tjera kur gjenden shumë pranë njera tjetrës në një mjedis të lëngshëm. Tani, fizikanti Jordi Faraudo i Universitetit Autonom të Barcelonës dhe kimisti Fernando Bresme nga Imperial College i Londrës studjuan në çdo detaj këtë forcë misterioze e njohur si "forca e hidratimit" dhe zbuluan origjinën e saj.

Në të njëjtën mënyrë si flamuri valëvitet në drejtimin e erës, në nivelin mikroskopik molekulat e ujit tërhiqen në drejtimin e një fushe elektrike. Gjithsesi, kur uji është në kontakt me sipërfaqe që krijojnë fusha të vogla elektrike - për shembull me përbërje kimike si ato të pluhurit larës - ndodh diçka tjetër.

Molekulat e ujit kanë aftësinë të organizohen në struktura komplekse të orientuara në mënyrë që të eliminojnë fushën elektrike e, në disa raste, ta kthejnë në kah të kundërt. Ky fenomen ishte studiuar nga të njëjtët kërkues dhe ishte përshkruar në revistën *Physical Review Letters* në prill 2004.

Tani shkencëtarët kanë zbuluar se kjo aftësi e çuditshme është përgjegjëse edhe për forcën e hidratimit që vepron kur uji është i rrethuar nga disa tipe molekulash të ngarkuara elektrostatisht si ADN-ja dhe përbërje të tjera biologjike. Ky zbulim u përshkrua përsëri së fundi në një artikull të revistës *Physical Review Letters*.